

09/ZDP/VE/2025
Datë: 10 mars 2025

Në mbështetje të nenit 15.1 (j), nenit 21 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil, të ndryshuar me Ligjin Nr. 08/L-063 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që kanë të bëjnë me racionalizimin dhe vendosjen e vijave llogaridhënëse të Agjencive të Pavarura; neneve 76.3 dhe 115 të Rregullores (AAC) Nr. 05/2020 për Rregullat e përbashkëta në fushën e aviacionit civil dhe themelimin e Agjencisë së Bashkimit Evropian për Sigurinë e Aviacionit; Rregullores (AAC) Nr. 08/2019 që përcakton rregullat e hollësishme për operimin e balonave; dhe Udhëzimit Administrativ (AAC) Nr. 02/2021 për zbatimin e specifikimeve të certifikimit, mjetëve të pranueshme të pajtueshmërisë dhe materialeve udhëzuese të EASA;
Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës merr:

VENDIM

1. Për zbatim në rendin e brendshëm juridik të Republikës së Kosovës të mjetëve të pranueshme të pajtueshmërisë (AMC) materialeve udhëzuese (GM) dhe të specifikimeve të certifikimit, bazuar në Vendimet e lëshuara nga EASA deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi, në fushën e Operimeve Ajrore me Balon, në vijim:

a) Mjetet e pranueshme të pajtueshmërisë/materialet udhëzuese (AMC/GM) për Rregulloren (AAC) Nr. 08/2019, janë:

AMC & GM të Rregullores

2018/004/R	Botimi Fillestar
2020/003/R	Botimi 1, Amandamenti 1
2020/002/R	Botimi 1

b) Specifikimet e certifikimit/materialet udhëzuese (CS/GM) për Rregulloren (AAC) Nr. 08/2019, janë:

CS & GM

2011/012/R	CS-31GB/ Botimi Fillestar
2011/013/R	CS-31HB/ Amandamenti 1
2013/011/R	CS-31TGB/ Botimi Fillestar

2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Burim Dinarama
U.D. Drejtor i Përgjithshëm



Tu dërgohet:

- Njesisë përgjegjëse të Sigurisë së Fluturimeve në AAC;
- Arkivi të AAC-së.